142	ADEM	BEKTASH	TROKA	2022	18/32	729	809	589761	KAFARAJ	KONF1RMUAR NGAZRPP
143	XHELO	ARIF	TROKA	2022	18/31	504	809	407736	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
144	QENAN	SHAIP	TROKA	2022	18/30	357	809	288813	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
145	NAZMI	QENAN	TROKA	2022	18/29	382	809	309038	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
146	BAFTJAR	QENAN	TROKA	2022	18/28	437	809	353533	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
147	NEBI	QENAN	TROKA	2022	18/27	406	809	328454	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
148	DYLBER	NEBI	TROKA	2022	18/26	579	809	468411	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
149	ILMI	QENAN	TROKA	2022	18/25	534	809	432006	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
150	PETRIT	BEKTASH	TROKA	2022	18/24	477	809	385893	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
151	BEKTASH	SHAIP	TROKA	2022	18/23	504	809	407736	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
152	MUSTAFA	BEKTASH	TROKA	2022	18/22	539	809	436051	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
153	PAJTIM	BEKTASH	TROKA	2022	18/21	768	809	621312	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
154	PELLUMB	QAMIL	TROKA	2022	18/20	899	809	727291	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
155	NURI	NEIM	AMATAJ	2022	106/1	1184	809	957856	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
156	KASO	QAZIM	MUCA	2022	104/1	2360	809	1909240	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
157	LAVER	AVDI	HAMATAJ	2022	104/2	1498	809	1211882	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
158	FIQIRI	FETI	HAMATAJ	2022	104/3	905	809	732145	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
159	BESNIK	FETI	HAMATAJ	2022	104/4	1089	809	881001	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
160	FETI	AVDI	HAMATAJ	2022	104/5	1671	809	1351839	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
161	ZYDI	SERRIK	HAMATAJ	2022	104/6	1981	809	1602629	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
162	RRAPO	JAUP	HAMATAJ	2022	104/8	1309	809	1058981	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
163	TOMOR	RRAPO	HAMATAJ	2022	104/9	1035	809	837315	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
164	MELSI	RRAPO	HAMATAJ	2022	104/10	1056	809	854304	KAFARAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
165	TAJAR	ISMAIL	TROKA	1001	161/1	1116	691	771156	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
166	ENGJELL	TAJAR	TROKA	1001	161/2	530	691	366230	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
167	FECORR	MURAT	TROKA	1001	161/3	244	691	168604	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP

168	HAMDI	MURAT	TROKA	*1001*	161/4	98	691	67718	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
169	ALI	SULO	TROKA	1001	162/1	513	691	354483	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
170	AMDI	MURAT	TROKA	1001	162/5	739	691	510649	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
171	ZANI	ISMAIL.	TROKA	1001	162/10	352	691	243232	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
172	TAJAR	ISMAIL	TROKA	1001	162/8	287	691	198317	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
173	FECORR	MURAT	TROKA	1001	162/6	17	691	11747	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
174	HAKI	ISMAIL	TROKA	1001	162/7	82	691	56662	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
175	IZMIR	TAJAR	TROKA	1001	162/9	135	691	93285	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
176	ZENEL	XHAFER	TROKA	1001	162/11	464	691	320624	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
177	SELMAN	OSMEN	TROKA	1001	162/12	506	691	349646	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
178	KALEM	OSMEN	TROKA	1001	162/13	399	691	275709	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
179	MYSHKE		TROKA	1001	162/14	527	691	364157	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
180	KUJTIM	KOVAC	FERRA	1001	162/18	515	691	355865	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
181	SEFER	SALI	FERRA	1001	162/19	509	691	351719	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
182	HAIR	HAXHI	ZEQAJ	1001	162/21	559	691	386269	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
183	HASIM	AZBI	TROKA	1001	162/22	770	691	532070	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
184	HASIM	AZBI	TROKA	1001	162/24	338	691	233558	ADE	KONFIRMUARNGAZRPP
185	HAKI	ISMAIL	TROKA	1001	162/26	327	691	225957	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
186	IZMIR	TAJAR	TROKA	1001	162/27	395	691	272945	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
187	IMBERLI	ISMAIL	TROKA	1001	162/28	1862	691	1286642	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
188	SHEFQET	ISMAIL	TROKA	1001	162/29	518	691	357938	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
189	AGIM	AHMET	JESHILI	1001	162/31	289	691	199699	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
190	ZINI	ISMAIL	TROKA	1001	162/32	1112	691	768392	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
191	AGIM	AHMET	JESHILI	1001	162/33	224	691	154784	ADE	KONFIRMUAR NGA ZRPP
192	FERDINANT	VENDIM	TAULLAJ	1001	199/1	3000	691	2073000	ADE	KONFIRMUAR NGA ZRPP
193	JONUZ	ZEQIR	ZEQAJ	1001	199/2	749	691	517559	ADE	KONFIRMUARNGAZRPP
194	ZEQIR	JONUZ	ZEQAJ	1001	199/3	677	691	467807	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
195	RESHAT	JONUZ	ZEQAJ	1001	199/4	1011	691	698601	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
196	IZET	VEIZ	ZEQAJ	1001	199/5	623	691	430493	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
197	LUTFI	VEIZ	ZEQAJ	1001	199/6	136	691	93976	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
198	MEZIN	REFIT	DRIZA	1001	199/7	202	691	139582	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
199	VEZIR	XHEMAL	VELO	1001	200/11	21	691	14511	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
200	FETI	XHEMAL	VELO	1001	200/12	149	691	102959	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
201	VELI	XHEMAL	VELO	1001	200/13	269	691	185879	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
202	MELEQ	HEKURAN	FERKO	1001	200/14	971	691	670961	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
203	HYSNI	MELEQ	FERKO	1001	200/15	1192	691	823672	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
204	CAUSH	MELEQ	FERKO	1001	200/17	488	691	337208	ADE	KONF1RMUAR NGAZRPP
205	BEQAR	MELEQ	FERKO	1001	200/16	1200	691	829200	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
206	DALIP	HEKURAN	FERKO	1001	200/18	1304	691	901064	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
207	HAREDIN	NOVRUZ	YZEIRI	1001	200/19	923	691	637793	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
208	FADIL	DALIP	FERKO	1001	200/20	537	691	371067	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
209	AGIM	TOFIK	KANANI	1001	200/21	1189	691	821599	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
210	FEIM	TOFIK	KANANI	1001	127/18	426	691	294366	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
211	AGIM	TOFIK	KANANI	1001	127/19	429	691	296439	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
212	MYSLYM	TOFIK	KANANI	1001	127/20	548	691	378668	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP

213	FAIK	MYSLYM	KANANI	1001	127/21	576	691	398016	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
214	FETI	XHEMAL	VELO	1001	127/22	326	691	225266	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
215	SHYQYRI	ISA	VELA	1001	127/23	426	691	294366	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
216	VEZIR	XHEMAL	VELO	1001	127/24	450	691	310950	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
217	FERIK	BAJRAM	ZGURALI	1001	127/25	415	691	286765	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
218	FERMAN	FERIK	ZGURALI	1001	127/26	358	691	247378	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
219	FATMIR	FERIK	ZGURALI	1001	127/27	726	691	501666	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
220	PELLUMB	FERIK	ZGURALI	1001	127/28	714	691	493374	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
221	BESIM	FERIK	ZGURALI	1001	127/29	168	691	116088	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
222	VELI	XHEMAL	VELO	1001	127/30	102	691	70482	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
223	AGUR	XHEMAL	VELO	1001	127/31	1207	691	834037	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
224	SEIT	XHEMAL	VELO	1001	127/32	481	691	332371	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
225	DALIP	HEKURAN	FERKO	1001	127/38	60	691	41460	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
226	MELEQ	HEKURAN	FERKO	1001	127/39	1275	691	881025	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
227	CAUSH	MELEQ	FERKO	1001	127/40	919	691	635029	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
228	SADIK	BEXHET	TROKA	1001	127/43	1327	691	916957	ADE	KONFIRMUAR NGAZRPP
229	GEZIM	BRAHIM	TROKA	3356	140/1	183	751	137433	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
230	BRAHIM	HAXHI	TROKA	3356	140/2	195	751	146445	SHEQMUSALAJ	KONFIRMUARNGAZRPP
231	SHEFQET	BRAHIM	TROKA	3356	140/3	218	751	163718	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
232	MALO	HAXHI	TROKA	3356	140/4	208	751	156208	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
233	BAJRAM	SELMAN	TROKA	3356	140/5	217	751	162967	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
234	MEHMET	SELMAN	TROKA	3356	140/6	261	751	196011	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
235	KUDRET	SELMAN	TROKA	3356	140/7	259	751	194509	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
236	BASHKIM	SELMAN	TROKA	3356	140/8	262	751	196762	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
237	ZINI	SELMAN	TROKA	3356	140/9	289	751	217039	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
238	NEKI	HAXHI	TROKA	3356	140/10	286	751	214786	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
239	QEMAL	SELMAN	TROKA	3356	140/11	283	751	212533	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
240	XHEVDET	SELMAN	TROKA	3356	140/12	273	751	205023	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
241	RAMIZ	TAIP	TROKA	3356	140/13	366	751	274866	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
242	IZAT	RAMIZ	TROKA	3356	140/14	282	751	211782	SHEQMUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
243	KASEM	IZET	TROKA	3356	140/15	284	751	213284	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
244	OSMAN	HEKURAN	TROKA	3356	140/16	273	751	205023	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
245	HEKURAN	RAMIZ	TROKA	3356	140/17	275	751	206525	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
246	FEJZO	RAMI	TROKA	3356	140/18	334	751	250834	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
247	VIKTOR	SHYQYRI	TROKA	3356	140/20	270	751	202770	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
248	BILBIL	SHYQYRI	TROKA	3356	140/21	289	751	217039	SHEQMUSALAJ	KONFIRMUARNGAZRPP
249	FEQOR	SALI	TROKA	3356	140/22	279	751	209529	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
250	YLVI	SULO	TROKA	3356	140/23	302	751	226802	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
251	HURMA	RAKIP	TROKA	3356	140/24	233	751	174983	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
252	MESUT	TAIP	TROKA	3356	140/25	1702	751	1278202	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
253	SAMO	XHAFER	TROKA	3356	140/26	328	751	246328	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
254	NEXHIP	XHAFER	TROKA	3356	140/27	307	751	230557	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGA ZRPP
255	BUJAR	XHAFER	TROKA	3356	140/28	257	751	193007	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
256	RAMAZAN	XHAFER	TROKA	3356	140/30	290	751	217790	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
257	FADIL	NEXHIP	TROKA	3356	140/31	282	751	211782	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP

258	FATBARDHA	BAJRAM	TROKA	3356	140/32	301	751	226051	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
259	SADIK	NEXHIP	TROKA	3356	140/33	1406	751	1055906	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
260	FADIL	NEXHIP	TROKA	3356	140/35	1363	751	1023613	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
261	SAMO	XHAFER	TROKA	3356	140/36	2092	751	1571092	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
262	BUJAR	XHAFER	TROKA	3356	140/38	254	751	190754	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
263	FATBARDHA	BAJRAM	TROKA	3356	140/39	40	751	30040	SHEQ MUSALAJ	KONFIRMUAR NGAZRPP
		TOTALI				**140346**		**89459818**		

VENDIM
Nr.1507, datë 19.11.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRJE-SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr.9836 datë 26.11.2007, "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Hyrje-Shkodër.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen tokë/truall 4115 (katër mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) m^2, me një vlerë totale shpronësimi 88 475 540 (tetëdhjetë e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 88 475 540 (tetëdhjetë e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të fillojë më 20 nëntor 2008 dhe të përfundojë më 30 dhjetor 2008.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS HYRJA QYTET-VAZHDIM TE KALAJA (SHKODËR) DHE "URA E RE E BUNËS"

Nr.	Pronari			Z.K	Nr.pas	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera totale/lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Sandër	Pashk	Luani	8591	18/699	Truall	720	21564	15526080	Konfirmuar nga ZRPP
2	Benjamin	Pjerin	Daberdaku	8591	18/112	Truall	1518	21564	32734152	Konfirmuar nga ZRPP
3	Benjamin	Pjerin	Daberdaku	8591	18/698	Truall	862	21564	18588168	Konfirmuar nga ZRPP
4	Benjamin	Pjerin	Daberdaku	8591	18/114	Truall	442	21564	9531288	Konfirmuar nga ZRPP
5	Selami		Bushati	8591	18/107	Truall	246	21564	5304744	Konfirmuar nga ZRPP
6	Antonio Leonard		Matia Matia	8591	18/697	Truall	58	21564	1250712	Konfirmuar nga ZRPP
7	Anjeze		Mjeda	8591	18/696	Truall	12	21564	258768	Konfirmuar nga ZRPP
8	Trashëgimtarë Gjonej			8591	18/121	Truall	135	21564	2911140	Konfirmuar nga ZRPP
9	Trashëgimtarë Daca Tuzi			8591	18/1	Truall	90	21564	1940760	Konfirmuar nga ZRPP
10	Nosh		Gjelaj	8597	14/99	Truall	32	13429	429728	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI					**4115**		**88475540**	

VENDIM
Nr.1508, datë 19.11.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR UNAZA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr.9836 datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Shkodër (kolektorët).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1617 (një mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) m^2 tokë truall, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 24 025 033 (njëzet e katër milionë e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 24 025 033 (njëzet e katër milionë e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e tre) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të fillojë më 30 nëntor 2008 dhe të përfundojë më 30 dhjetor 2008.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim ZRPP", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Për pronarët, për të cilët është shënuar "Proces regjistrimi", Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve do të bëjë likuidimin, pasi të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrat e pasurive, në pronësi të pronarëve, që shpronësohen.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E PERSONAVE, PRONAT E TË CILËVE PREKEN NGA REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA SHKODËR"

Nr.	Pronari			Zona kad.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Trashëgimtarët		Anemali	8591	8/824	truall	810	13429	10877490	Konfirmim
2	Trashëgimtarët		Lluja	8591	8/440	truall	400	13429	5371600	Konfirmim
3	Smajl	Caf	Shyti	8592	7/529	truall	13	21564	280332	Konfirmim
4	Shpresim	Nazif	Tola	8591	8/11	truall	40.5	13429	543874.5	Konfirmim
5	Hatixhe		Deltina	8592	7/566	truall	14	21564	301896	Konfirmim
6	Sabri		Hebovia	8592	7/87	truall	36	21564	776304	Konfirmim
7	Mersin	Ali	Jahja	8591	6/308	truall	103	21564	2221092	Konfirmim
8	Ahmet		Osja	8591	13/340	truall	5	13429	67145	Proces.regj.
9	Xhavid	Hamza	Jakupi	8591	13/375	truall	15.5	21564	334242	Konfirmim
10	Selaudin		Jakupi	8591	13/373	truall	9.5	21564	204858	Konfirmim
11	Fadil		Pirani	8591	5/89,5/88	truall	37	21564	797868	Proces.regj
12	Haki		Hoxha	8591	3/301	truall	16	21564	345024	Konfirmim
13	Nazmi		Kruja	8591	6/739	truall	45.5	13429	611019.5	Konfirmim
14	Medi		Duda	8591	6/616	truall	25	21564	539100	Konfirmim
15	Petrit		Barbullushi	8591	8/435	truall	32	13429	429728	Konfirmim
16	Kujtim		Ferhati	8591	6/761	truall	5	21564	107820	Konfirmim
17	Ahmet		Osja	8591	13/343	truall	10	21564	215640	Konfirmim
	Shuma						**1617**		**24025033**	

VENDIM
Nr.1511, datë 29.11.2008

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN E SHKOLLËS RAJONALE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (ReSPA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes për themelimin e shkollës rajonale të administratës publike (ReSPA), të datës 12 shtator 2008, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1512, datë 19.11.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 24 nëntor 2008, të dy autokolonave ushtarake sllovene, të përbëra, si më poshtë vijon:

a) Autokolona e parë, me 1 (një) automjet dhe 5 (pesë) trupa;

b) Autokolona e dytë, me 2 (dy) automjete dhe 5 (pesë) trupa.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e parë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e dytë është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalmit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Gjatë itinerarit të hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, autokolonat ushtarake sllovene të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1513, datë 19.11.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 22 nëntor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 14 (katërmbëdhjetë) automjete dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 24 nëntor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 7 (shtatë) automjete dhe 18 (tetëmbëdhjetë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 22 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Ndërsa pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 24 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Gjatë itinerarit të hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, autokolonat ushtarake italiane, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1514, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË

NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE DHE DEGA E DOGANËS SË TIRANËS, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe degës së doganës së Tiranës, të përfundojë, deri në datën 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për mallra e shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Aneksi i vendimit të Këshillit të Ministrave

Në lekë

Nr.	EMËRTIMI I PROJEKTIT	VLERA
	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	
1	Pajisje zyre dhe elektronike	
	- Loti II "Blerje dhenesa peshe"	4,600,000
	- Loti III "Blerje softwar-i antivirus"	2,163,000
	Dega e doganës Tiranë	
1	Shtrim asfaltim i sheshit	8,100,000
2	Ndërtim i pikës së kontrollit fizik	4,120,800

VENDIM
Nr.1515, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LEJES, PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR, KALLMET/LEZHË (SHQIPËRI)-ZAPPONETA/MANFREDONIA (ITALI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë

dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë (Shqipëri) – Zapponeta/Manfredonia (Itali).

2. Miratimin e lejes nr.4, datë 17.11.2008 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Kallmet/Lezhë (Shqipëri) – Zapponeta/Manfredonia (Itali)", dhënë shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k. sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Revokimin e lejes nr.1, datë 13.11.2007, dhënë shoqërisë "ASG Power Albania" sh.a.

4. Vendimi nr.778, datë 14.11.2007 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Seman (Shqipëri) – Foxhia (Itali)", shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi psa botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të ligjit nr.9776, datë 12.7.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar", dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit", të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.725, datë 7.11.2007 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit dhe të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit".

I jepet shoqërisë "BIOPOWER GREEN ENERGY SHPK"

Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, me nr. serial SN -004412-12-07, me datë 5.12.2007 dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me numër NIPTI: K72405024M, me seli në Tiranë, rruga "Sulejman Delvina", Qendra e Biznesit Zayed.

LEJE
PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR, NDËRMJET KALLMET/LEZHË (SHQIPËRI) DHE MANFREDONIA (ITALI)

Nr.4, datë 17.11.2008

- Leja jepet për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, qarku Lezhë, komunat Kallmet dhe Shëngjin (Shqipëri) – rajoni i Pulias, komuna e Manfredonias dhe Foggias (Itali), pa akses të palëve të treta.

- Shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k., ka të drejtën e shfrytëzimit të kapacitetit të kësaj linje vetëm pasi të ketë vënë në punë parkun e erës dhe centralin me biomasë, për prodhimin e

energjisë elektrike në zonën e Lezhës.

- Karakteristikat kryesore të linjës janë:
- Linjë e tensionit të lartë e rrymës së vazhduar;
- Drejtimi i kalimit të energjisë do të jetë në dy drejtimet: Shqipëri – Itali dhe Itali – Shqipëri;
- Tensioni nominal do të jetë Un = 500 kV;
- Kapaciteti total i fuqisë transmetuese të kësaj linje është 1,000 MW;
- Kapaciteti minimal i fuqisë është: Pmin = 10% e Pn;
- Puna për ndërtimin e linjës duhet të fillojë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj lejeje;
- Leja hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të jenë lidhur kontratat përkatëse që parashikohen në këtë leje;
- Shoqëria Biopower Green Energy sh.p.k., brenda 6 muajve nga miratimi i kësaj lejeje, duhet të lidhë një kontratë me OST sh.a.-në, për mënyrën e ndërtimit dhe të funksionimit të linjës tregtare të interkonjeksionit;
- Pika e lidhjes së rrjetit elektrik, të ndërtuar nga shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k., me sistemin elektroenergjetik shqiptar do të jetë konform kontratës që kjo shoqëri do të lidhë me OST sh.a.-në;
- Shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k., para fillimit të punimeve, duhet të depozitojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dokumentet përkatëse, që vërtetojnë mbështetjen financiare për realizimin e këtij projekti;
- Koha e realizimit të projektit për ndërtimin e kësaj linje, lidhjen me sistemin elektroenergjetik shqiptar dhe vënia në shfrytëzim do të jetë 4 (katër) vjet nga data e fillimit të punës për ndërtimin e saj;
- Fillimi i punës për ndërtimin e linjës konsiderohet data e nënshkrimit të një procesverbali me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pas paraqitjes nga ana e shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k., te kjo ministri, të dokumentacionit përkatës;
- Leja i jepet shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k., për shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit për një afat 20-vjeçar, nga data e vënies në punë të saj;
- Leja jepet me të drejtën që shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. të përdorë 80% të kapacitetit transmetues të kësaj linje dhe 20% e kapacitetit transmetues të kësaj linje i jepet për shfrytëzim pa pagesë OST sh.a. Shqipëri;
- Në rastet kur linja tregtare e rrymës së vazhduar punon e ndarë nga sistemi elektroenergjetik shqiptar, atëherë shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k., është e detyruar t'i kalojë OST sh.a. 20% të fitimit të realizuar nga tranzitimi i energjisë elektrike nëpër këtë linjë;
- Për të gjithë kohëzgjatjen e lejes, edhe sikur të jetë një situatë e kapaciteteve të limituara, shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. do t'i sigurojë falas OST sh.a.-së, kuotën e kapaciteteve, për të cilën nuk i është dhënë përjashtimi nga aplikimi i së drejtës për akses të palëve të treta;

- Gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe të funksionimit të linjës së interkonjeksionit, shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. është e detyruar të respektojë të gjithë kuadrin ligjor dhe rregullator të sektorit të energjisë elektrike;
- Të gjitha asetet që mundësojnë funksionimin e kësaj linje dhe kalimin e energjisë elektrike nga njëri vend te tjetri, në fund të periudhës së lejes, i kalojnë OST sh.a.-së, në Shqipëri pa pagesë;
- Pjesa e rrjetit, që do të ndërtohet nga "Biopawer Green Energy" sh.p.k., për të realizuar lidhjen e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrjetin ekzistues të transmetimit, që në ndërtimin e saj, do të jetë pjesë e rrjetit kombëtar të transmetimit, dhe kalon në pronësi të OST sh.a.-së pa pagesë;
- OST sh.a. nuk është e detyruar të tranzitojë në rrjetin e administruar prej saj energjinë elektrike të prodhuar nga centralet elektrike të shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k.;
- OST sh.a. nuk është e detyruar të tranzitojë në rrjetin e administruar prej saj, energji elektrike të siguruar nga burime të tjera gjeneruese brenda apo jashtë Shqipërisë dhe që duhen transmetuar në drejtim të Italisë nëpërmjet kësaj linje tregtare interkonjeksioni, për llogari të shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k.;
- Leja konsiderohet automatikisht e revokuar në rastet kur:

1. Shoqëria "Biopawer Green Energy" sh.p.k. nuk paraqet brenda një periudhe prej 12

muajsh, nga data e lëshimit të kësaj lejeje, të gjithë dokumentacionin, autorizimet apo lejet e ndryshme, që kërkohen për ndërtimin e kësaj linje.

2. Shoqëria "Biopawer Green Energy" sh.p.k. nuk depoziton pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda një periudhe 12-mujore, dokumentet përkatëse që vërtetojnë mbështetjen dhe garancinë financiare për realizimin e këtij projekti.

3. Shoqëria "Biopawer Green Energy" sh.p.k. nuk paraqet, para fillimit të punimeve për ndërtimin e kësaj linje, dokumentacionin përkatës që provon fillimin e ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë elektrike, për transmetimin e së cilës është kërkuar ndërtimi i kësaj linje.

4. Shoqëria "Biopawer Green Energy" sh.p.k. nuk fillon punën në afatin e parashikuar në këtë leje.

5. Shoqëria "Biopawer Green Energy" sh.p.k. nuk përfundon në afatin e përcaktuar në këtë leje realizimin e plotë të projektit për ndërtimin e kësaj linje, lidhjen me sistemin elektroenergjetik shqiptar, sipas skemës së rënë dakord me OST sh.a., dhe vënien në punë të tyre.

- Për rastet kur "Biopawer Green Energy" sh.p.k., nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në shkronjat "d", "ë" dhe "f" të pikës 2.3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit", si dhe nuk merr masat e menjëhershme për sigurimin e sistemit elektrik kombëtar, ministria i jep 30 ditë kohë për t'i përmbushur detyrimet.

Nëse shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. përsëri nuk i përmbush ato, atëherë leja e dhënë revokohet.

- Kohëzgjatja e kësaj lejeje është 20 vjet, duke filluar nga data e vënies në punë të kësaj linje.

Kjo leje nuk do të zëvendësojë ndonjë kompetencë të ndonjë autoriteti ose institucioni tjetër shtetëror ekzistues për të dhënë leje, pëlqimin ose çdo dokument tjetër, që kërkohet për ndërtimin e centraleve të reja gjeneruese të energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi.

Tiranë, më 17.2.2008

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

VENDIM
Nr.1516, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LEJES, PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR, PORTO ROMANO/DURRËS (SHQIPËRI) – CASAMASSIMA/BARI (ITALI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Porto Romano/Durrës (Shqipëri) – Casamassima/Bari (Itali).

2. Miratimin e lejes nr.3, datë 1.10.2008 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Porto Romano/Durrës (Shqipëri) – Casamassima/Bari (Itali)", dhënë shoqërisë "ENEL Produzione S.p.A", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të ligjit nr.9776, datë 12.7.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjise elektrike", të ndryshuar", dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit", ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.725, datë 7.11.2007 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit".

I jepet shoqërisë anonime "ENEL Produzione S.p.A."

Regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve të Romës, me kod fiskal dhe numër TVSH-je 05617841001, në datën 29.10.1998, me seli në Romë, rruga "Regina Margherita", nr.125.

LEJE
PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT, ME RRYMË TË VAZHDUAR, NDËRMJET PORTO ROMANO/DURRËS (SHQIPËRI) DHE CASAMASSIMA/BARI (ITALI)

Nr.3, datë 1.10.2008

- Leja jepet për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit, me rrymë të vazhduar, Porto Romano/Durrës (Shqipëri) — dhe Casamassimal Bari (Itali), pa akses të palëve të treta.
- Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." ka të drejtën e shfrytëzimit të kapacitetit të kësaj linje vetëm pasi të ketë vënë në punë termocentralin për prodhimin e energjisë elektrike në zonën e Porto Romanos.
- Karakteristikat kryesore të linjës janë:
- Linjë e tensionit të lartë e rrymës së vazhduar;
- Drejtimi i kalimit të energjisë do të jetë në të dy drejtimet: Shqipëri - Itali dhe Itali – Shqipëri;
- Tensioni nominal do të jetë: Un = 500 kV;
- Kapaciteti total i fuqisë transmetuese të kësaj linje është 500 MW;
- Kapaciteti minimal i fuqisë është Pmin = 10 % e Pn;
- Puna për ndërtimin e linjës duhet të fillojë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj lejeje;
- Leja hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të jenë paraqitur

kontratat përkatëse, që parashikohen në këtë leje.

Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A.", brenda 6 muajve nga miratimi i kësaj lejeje, duhet të lidhë një kontratë me OST sh.a.-në, për mënyrën e ndërtimit dhe të funksionimit të linjës tregtare të interkonjeksionit.

- Pika e lidhjes së rrjetit elektrik, të ndërtuar nga shoqëria "ENEL Produzione S.p.A.", me sistemin elektroenergjetik shqiptar do të jetë konform kontratës, që kjo shoqëri do të lidhë me OST sh.a.

- Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A.", para fillimit të punimeve, duhet të depozitojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dokumentet përkatëse, që vërtetojnë mbështetjen financiare për realizimin e këtij projekti.

- Koha e realizimit të projektit për ndërtimin e kësaj linje, lidhja me sistemin elektroenergjetik shqiptar dhe vënia në shfrytëzim do të jetë 6 (gjashtë) vjet nga data e fillimit të punës për ndërtimin e saj nga "ENEL Produzione S.p.A.".

- Fillimi i punës për ndërtimin e linjës konsiderohet data e nënshkrimit të një procesverbali me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pas paraqitjes nga ana e shoqërisë ENEL Produzione S.p.A te kjo ministri, të dokumentacionit përkatës.

- Leja i jepet shoqërisë "ENEL Produzione S.p.A." për shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit për një afat 20-vjeçar, nga data e vënies në punë të saj.

- Leja jepet me të drejtën që shoqëria ENEL Produzione S.p.A. të përdorë 80% të kapacitetit transmetues të kësaj linje dhe 20% të kapacitetit transmetues të kësaj linje i jepet për shfrytëzim pa pagesë OST sh.a., Shqipëri.

- Në rastet kur linja tregtare e rrymës së vazhduar punon e ndarë nga sistemi elektroenergjetik shqiptar, atëherë shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." është e detyruar t'i kalojë OST sh.a. 20% të fitimit të realizuar nga shfrytëzimi 20% i kapacitetit të kësaj linje.

- Për të gjithë kohëzgjatjen e lejes, edhe sikur të jetë një situatë e kapaciteteve të limituara, shoqëria "ENEL Produzione S.p.A.", do t'i sigurojë falas OST sh.a.–së, kuotën e kapaciteteve, për të cilën nuk i është dhënë përjashtimi nga aplikimi i së drejtës për akses të palëve të treta.

- Gjatë të gjithë periudhës së ndërtimit dhe të funksionimit të linjës së interkonjeksionit, shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." është e detyruar të respektojë të gjithë kuadrin ligjor dhe rregullator të sektorit të energjisë elektrike.

- Të gjitha asetet që mundësojnë funksionimin e kësaj linje dhe kalimin e energjisë elektrike nga njëri vend te tjetri, në fund të periudhës së lejes, i kalojnë OST sh.a.-së në Shqipëri pa pagesë.

- Pjesa e rrjetit, që do të ndërtohet nga "ENEL Produzione S.p.A." për të realizuar lidhjen e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrjetin ekzistues të transmetimit, që në ndërtimin e saj, do të jetë pjesë e rrjetit kombëtar të transmetimit, dhe kalon në pronësi të OST sh.a.-së pa pagesë.

- OST sh.a. nuk është e detyruar të tranzitojë në rrjetin e administruar prej saj energjinë elektrike të prodhuar nga termocentrali i shoqërisë "ENEL Produzione S.p.A.".

- OST sh.a. nuk është e detyruar të tranzitojë, në rrjetin e administruar prej saj, energji elektrike të siguruar nga burime të tjera gjeneruese brenda apo jashtë Shqipërisë dhe që duhen transmetuar në drejtim të Italisë nëpërmjet kësaj linje tregtare interkonjeksioni, për llogari të shoqërisë "ENEL Produzione S.p.A.".

- Leja konsiderohet automatikisht e revokuar në rastet kur:

1. Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." nuk paraqet brenda një periudhe prej 12 muajsh, nga data e lëshimit të kësaj lejeje, të gjithë dokumentacionin, autorizimet apo lejet e ndryshme, që kërkohen për ndërtimin e kësaj linje.

2. Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." nuk fillon punën në afatin e parashikuar në këtë leje.

3. Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." nuk përfundon në afatin e përcaktuar në këtë leje realizimin e plotë të projektit për ndërtimin e kësaj linje, lidhjen me sistemin elektroenergjetik shqiptar, sipas skemës të rënë dakord me OST sh.a. dhe vënien në punë të tyre.

4. Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." nuk paraqet, para fillimit të punimeve për ndërtimin e kësaj linje, dokumentacionin përkatës që provon fillimin e ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë elektrike, për transmetimin e së cilës është kërkuar ndërtimi i kësaj linje.

5. Shoqëria "ENEL Produzione S.p.A." nuk depoziton pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda një periudhë 12-mujore, dokumentet përkatëse që vërtetojnë mbështetjen dhe garancinë financiare për realizimin e këtij projekti.

- Për rastet kur "ENEL Produzione S.p.A." nuk përmbush detyrimet, e përcaktuara në shkronjat "d", "e" dhe "f" të pikës 2.3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 15.8.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit", si dhe nuk merr masat e menjëhershme për sigurimin e sistemit elektrik kombëtar, ministria i jep 30 ditë kohë për të përmbushur detyrimet.

Nëse "ENEL Produzione S.p.A." përsëri nuk i përmbush ato, atëherë leja e dhënë revokohet.

- Kohëzgjatja e kësaj lejeje është 20 vjet, duke filluar nga data e vënies në punë të kësaj linje.

Kjo leje nuk do të zëvendësojë ndonjë kompetencë të ndonjë autoriteti ose institucioni tjetër shtetëror ekzistues për të dhënë leje, pëlqimin ose çdo dokument tjetër që kërkohet, sipas legjislacionit në fuqi.

Tiranë, më 1 tetor 2008

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

VENDIM
Nr.1517, datë 19.11.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.495, DATË 1.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHTESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.495, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 "Paga mujore e personelit diplomatik, të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në shtetet e huaja", e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhjet nr.3 "Paga mujore e personelit administrativo-teknik (me kohë të plotë) të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja", dhe nr.3/1 "Paga mujore e personelit administrativo-teknik (me kohë të pjesshme) të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja", të përmendura në pikat 8 e 9, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara, për rritjen e pagave, për vitin 2008.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data

1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Pozicioni	**Paga mujore**	
	1	**2**
	Paga bazë mujore (në euro dhe dollarë USD)	Shtesa për përfaqësim (në%)
Ambasador	1250 euro 1520 dollarë USD	75%
Konsull i Përgjithshëm Ministër Fuqiplotë Ministër Këshilltar	940 euro 1140 dollarëUSD	75% 40% 40%
Këshilltar	780 euro 990 dollarë USD	40%
Sekretari parë Konsull	630 780 dollarë USD	40%
Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	480 620 dollarë USD	40%
Sekretar i tretë Agjent konsull	430 530 dollarë USD	40%
Atashe	380 480 dollarë USD	40%

Lidhja nr. 3

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PLOTË), TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	**Paga mujore**				
	Grupi 1	**Grupi 2**	**Grupi 3**	**Grupi 4**	**Grupi 5**

Sekretar teknik Financier Specialist	790 euro 890 dollarë USD	750 euro 850 dollarë USD	720 euro 820 dollarë USD	690 euro 790 dollarë USD	640 euro 740 dollarë USD
Shofer	750 euro 850 dollarë USD	710 euro 810 dollarë USD	680 euro 780 dollarë USD	650 euro 750 dollarë USD	600 euro 700 dollarë USD
Kafaz	620 euro 680 dollarë USD	580 euro 640 dollarë USD	550 euro 610 dollarë USD	520 euro 580 dollarë USD	470 euro 530 dollarë USD

Lidhja nr.3/1

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PJESSHME) TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	**Paga mujore (me kohë të pjesshme)**		
	Minimumi	**Maksimumi**	
Sekretar teknik Financier Specialist	280 euro 310 dollarë USD	420 euro 470 dollarë USD	
Pastrues	210 euro 230 dollarë USD	280 euro 310 dollarë USD	

VENDIM
Nr.1519, datë 21.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1415, DATË 22.10.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA", TIRANË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.1415, datë 22.10.2008 të Këshillit të Ministrave, pas shprehjes "...

8 dhjetor 2008.” shtohet shprehja, “... , ndërsa për pikën 3, të këtij aneksi, si afat të jetë data 29 dhjetor 2008.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1520, datë 21.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE DISA INSTITUCIONE NË VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe disa institucioneve në varësi të saj t’i përfundojnë, deri në datën 22 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, institucionet në varësi të saj dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR.1

I. Procedura që zhvillohen nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Informatizimi i arkiv-protokollit në Ministrinë e Shëndetësisë, me fond limit 4 166 600 lekë pa TVSH.

2. Sistemi i informacionit për Kujdesin Shëndetësor Parësor, me fond limit 20 818 750 lekë pa TVSH.

3. Projektpreventiv zbatimi për ndërtimin e godinës të sëmundjeve akute:

- spitali Shkodër, me fond limit 1 333 334 lekë pa TVSH.

II. Procedurat që zhvillohen nga institucionet spitalore të varësisë:

- Procedura për të cilat është shpallur fituesi, por nuk është nënshkruar kontrata:

a) Drejtoria e Shëndetit Publik Pogradec:

"Blerje lënde djegëse për ngrohje", me fond limit 2 833 600 lekë.

b) Drejtoria e Shëndetit Publik Krujë:

"Blerje pajisje mobilimi për spitalin Krujë", me fond limit 8 000 000 lekë (me TVSH).

"Blerje pajisje mjekësore për DSHP-në Krujë", me fond limit 2 000 000 lekë (me TVSH).

"Blerje pajisje mjekësore për spitalin Krujë", me fond limit 15 000 000 lekë (me TVSH). Ky fond u nda në dy lote: 9 000 000 lekë (me TVSH) do të tenderohet nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa 6 000 000 lekë (me TVSH) do të tenderohet nga DSHP-ja Krujë.

c) Drejtoria e Shëndetit Publik – Pukë:

"F.V. kaldajë për spitalin Pukë", me fond limit 1 500 000 lekë (me TVSH).

d) Drejtoria e Shëndetit Publik – Skrapar:

"Blerje pajisje mjekësore për spitalin Skrapar", me fond limit 1 300 000 lekë (me TVSH). Është tenderuar me vlerë 1 284 000 lekë (me TVSH).

"Blerje pajisje teknologjike për spitalin Skrapar", me fond limit 1 000 000 lekë (me TVSH). Është tenderuar me vlerë 974 400 lekë(me TVSH).

e) Spitali Gjirokastër: "Instalimi i pompave të ujit teknologjik për spitalin Gjirokastër", me fond limit 2 000 000 lekë (me TVSH). Është tenderuar me vlerë 1 994 520 lekë (me TVSH).

f) Drejtoria e Shëndetit Publik – Tepelenë: "Rikonstruksion i katit përdhe dhe çatisë së godinës dhe Tepelenë" me fond limit 4 400 000 lekë (me TVSH).

g) Drejtoria e Shëndetit Publik – Sarandë: "Ndërtim i murit mbajtës për urgjencën e re spitali Sarandë" me fond të çelur për vitin 2008, 5 000 000 lekë (me TVSH).

"Blerje pajisje mobilimi për urgjencën e spitalit Sarandë" me fond limit 2 500 000 lekë (me TVSH) është shpallur fituesi.

"Projektpreventiv zbatimi për rikonstruksionin e godinës së vjetër, spitali Sarandë", me vlerë limit 3 000 000 lekë (me TVSH).

h) Qendra Kombëtare e Teknikës Bio-Mjekësore — Tiranë: "Projektpreventiv zbatimi për rikonstruksionin e godinës së ofiçinës Tiranë", me vlerë limit 1 500 000 lekë (me TVSH). Pritet të lidhet kontrata.

i) Drejtoria e Shëndetit Publik – Kukës: "Rikonstruksion i ambienteve të reja për DSHP Kukës", me vlerë të akorduar për vitin 2008, 10 000 000 lekë (me TVSH), tenderuar me vlerë të plotë 18 000 000 lekë (me vlerë të plotë).

j) Autoriteti Shëndetësor Rajonal – Tiranë:

"Rikonstruksion i godinës 1-kat pranë poliklinikës nr.9 për vendosjen e aparatit të radiologjisë" me fond limit 1 500 000 lekë (me TVSH).

"Blerje E.E.G për poliklinikën qendrore Tiranë" me fond të akorduar 1 333 333 lekë (pa TVSH).

k) Spitali Fier: "Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore, impiantistikës dhe zyrave", me fond limit 1 995 280 lekë (pa TVSH).

"Blerje lëndë djegëse për ngrohje" me fond limit 5 010 440 lekë (pa TVSH).

m) Spitali psikiatrik Vlorë:

"Projektpreventiv zbatimi për rikonstruksionin e spitalit psikiatrik Vlorë sipas masterplanit", prokuruar, me fond limit 3 083 333 lekë (pa TVSH).

VENDIM
Nr.1521, datë 21.11.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOMJETI USHTARAK SLLOVEN, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë

vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit – Qafë-Thanë, në datën 24 nëntor 2008, të 1 (një) automjeti dhe 1 (një) personeli ushtarak slloven.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Automjeti slloven, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1522, datë 12.11.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PIKËS SË KALIMIT KUFITAR BLLATË/PESHKOPI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve, z.Mexhit Muça dhe z.Gani Muça, të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë/arë, me nr.pasurie 155/1 dhe 155, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që preken nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Bllatë/Peshkopi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, për sipërfaqen 1015 (një mijë e pesëmbëdhjetë) m^2, tokë/arë, të vlerësuar me çmimin 673 lekë/m^2, për zonën e Peshkopisë, përkatësisht: Mexhit Muça, për sipërfaqen 210 (dyqind e dhjetë) m^2, me 141 330 (njëqind e dyzet e një mijë e treqind e tridhjetë) lekë;

- Gani Muça, për sipërfaqen 805 (tetëqind e pesë) m^2, me 541 765 (pesëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 518 000 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 683 095 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga "Llogaria speciale", e krijuar si transfertë kapitale, për t'u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.11.2008 dhe të përfundojë me 30.12.2008.

7. Afati i punimeve të ndërtimit të fillojë brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi dhe të përfundojë brenda 12-muajve.

8. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe ZRPP-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

GEN - PLAN

Shkalla: 1 : 2500

Ndertimi i Prones DOGANA ELLATË

Pronari SHTETI

Adresa ELLATË, KOMUNA MARELLARE

Indeksi i Hartes M-34-89(80-D)

Zona KADASTRALE 1224

Zëri kadastral TRUALL

Siperfaqja totale _____ m 2

Siperfaqja nderteses _____ m 2

Zene me paisje elektrike _____ m 2

Siperfaqja funksionale _____ m 2

Siperfaqja jashte rrethimit _____ m 2



Rilevoi dhe hartoi

Top. G. Lazri

License nr. TZ. 0599

GAFUR LAZRI
Nr Lic TZ 0599

Kryetari i fshatit

(HAJRI MUSA)

KRYETARI i KOMUNES

(BARDHYL AGOLLI)

VENDIM
Nr.1523, datë 19.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.261, DATË 27.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I RISTRUKTURIMIT TË "ARMO" SHA, TIRANË DHE "ALBPETROL" SHA, PATOS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e vendimit nr.261, datë 27.2.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Shoqëritë do të përballojnë, me likuiditetet e veta, fondet e llogaritura për pagesën e punonjësve, që dalin të papunë, si më poshtë vijon:

a) 478 988 502 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë, për 606 punonjësit, që dalin pa punë nga ristrukturimi i "Armo" sh.a., Tiranë;

b) 672 200 000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy milionë e dyqind mijë) lekë, për 1100 punonjësit, që dalin pa punë, nga ristrukturimi i "Albpetrol" sh.a., Patos".

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1530, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS ULËZ TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Ulëz të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ulëz të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.362, datë 23.3.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ulëz, të qarkut të Dibrës".

2.Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Ulëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Ulëz — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i

në listën e inventarit		transferimit
12-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
8-11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve nëshëndetin publik.	Në pronësi
2-7	Varreza publike.	Në pronësi
369, 371-378	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
379,382,383,386-388,391, 392,395	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
361-363,365,367, (vetëm kanalet e treta) 380,381,384,385,389,390,393, 394,396	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
397,398	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës – kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.1531, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS OROSH TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Orosh të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Orosh të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.163, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Orosh, të qarkut të Lezhës".

2.Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Orosh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Orosh Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-18	Prona që përdoren për realizimin e programeve	Në pronësi

	arsimore.	
22-31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
19	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën administrative.	Në pronësi
20,21,851,851	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
32-40	Varrezat publike.	Në pronësi
46,858-867,869-884	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
41,42	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
755-758,763-766,771,772,777-780,785-787,792-794,799-801,806-808,812-814,818-820,825-827,831-833,837-839,843,844	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
759-762,767-770,773-776,781-784,788-791,795-798,802-805,809-811,815-817,821-824,828-830,834-836,840-842,845,846-850	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
857	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
885-891	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.1532, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KORÇË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Korçë të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 965 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë).

2.Ngarkohen Ministri e Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
28-34,35-45,46-52,54-78,925,927,947,948	Prona që përdoren në fushën e sportit kulturës & monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor.	Në pronësi
79,80,82-451	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
519-563,949,950,962	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
605,609	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
615-618,620-624,627,628,633-634 (vetëm pronat e shërbimit parësor)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin parësor.	Në pronësi
919,920,922	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
686-688,695-844,847-849,852,853,854,855,856,857 861-875,946,956,958,959, 960,961	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
685,877-918,921,923,924,926,929-935,951-955,957,963,964	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike.	Në pronësi
666,667,671,672	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative.	Në pronësi
637-638 (vetëm kanale të treta dhe toka pa fryt).	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë inproduktive dhe objekte të ish-NB-së).	Në pronësi
928	Rrjeti i ndriçimit publik.	Në pronësi

VENDIM
Nr.1533, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË PESHKOPI TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Peshkopi të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1445 (një mijë e katërqind e dyzet e pesë).

2. Ngarkohen Ministri e Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Peshkopisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4,7-35	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
59	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
64-84,86-91	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
152-154	Varreza publike	Në pronësi
98	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	
141-143,155-172,188,189,196,201,202,242-248,363,592-662,666,828	Infrastrukturë (troje të lira).	Në përdorim
151,173-187,190-195,197-200,203-241,249-362,364-591,746,752,755,1114-1333	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
148-150,668,673-675,677,721,732-753,755-762,772-777,819,820,822,823,826-828, 839,840,842,878-884,909,910 1432	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
979-994	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (prona të bujqësisë).	Në pronësi
127,132,136,137,139,140	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
911-978	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
1424-1431,1433-1445	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

VENDIM
Nr.1534, datë 19.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.662, DATË 8.10.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË SË KUÇOVËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.662, datë 8.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Përmasat e pronave nr.4 deri nr.8, 16, 17, 85, 86, 433, 444, 465, 475, 477, 479, 484, 490, 491 e 495, në bashkinë Kuçovë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

b) Shtohen pronat me nr.557 deri 567, sipas formularëve "Shtesa 1" e "Shtesa 2", që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Bashkisë së Kuçovës i transferohen pronat, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri e Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Kuçovës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kuçovë Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
557,564,565,566	Prona që shërbejnë për shërbime të ndryshme dhe zhvillim ekonomik.	Në pronësi
558,563,567	Prona që shërbejnë për strehim.	Në pronësi

VENDIM
Nr.78, datë 19.11.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT NË BANKËN E SHQIPËRISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "c", "f" dhe shkronja "g", dhe nenit 76 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 13, paragrafi i parë, pas togfjalëshit "... të njëpasnjëshëm të tyre, ...", shtohet togfjalëshi "…në Buletin Zyrtar të Agjencisë së Prokurimit Publik, ...";

b) në nenin 20, paragrafi i tretë, togfjalëshi "...do t'u kërkohet vendimi i gjykatës për regjistrimin si person fizik tregtar ose juridik, si dhe certifikata e regjistrimit në organin tatimor,..." zëvendësohet me togfjalëshin "....do t'u kërkohet vërtetimi për regjistrimin si person fizik tregtar ose juridik,...";

c) në nenin 30, paragrafi i parë, pas togfjalëshit "... do të jetë 10", shtohet togfjalëshi "...deri 20 ...";

d) neni 36, paragrafi i katërt ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Komisioni i prokurimit sipas objektit konkret të prokurimit, duke gjykuar dhe argumentuar vetë rëndësinë, natyrën e punës, kushtet teknike apo specifike tepër të veçanta të mallit të kërkuar apo ekzistencën e një strategjie apo politike të miratuar nga Banka e Shqipërisë, dhe mbështetur sipas rastit në argumentimet e bëra në kërkesën për prokurim të departamentit apo strukturës përkatëse të Bankës së Shqipërisë, mund të përcaktojë markat e mallrave, qoftë si kategori *"brand name"* qoftë si markë e individualizuar, duke marrë në çdo rast miratimin me shkrim nga Kryetari i Entit Prokurues. Në prokurimin e mallrave me markë të individualizuar, komisioni synon të prokurojë direkt me prodhuesin ose sipas njoftimit të këtij të fundit, me përfaqësuesin e autorizuar të tij.

e) në nenin 40 shtohet shkronja "d" sipas përmbajtjes së mëposhtme:

d) mungon kryetari i Komisionit dhe është i pamundur zëvendësimi i tij;

f) në nenin 40 shtohet paragrafi i tretë sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Për rastin e parashikuar në shkronjën "d" anëtari më i vjetër në moshë do të mbledhë dhe kryesojë mbledhjen e Komisionit të Prokurimit për shtyrjen e procedurës dhe caktimin e një date të re, e cila do të jetë jo më pak se 5 ditë pas datës së planifikuar për hapjen e ofertave.

g) në nenin 41, pika 1, shkronja "a" ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

a) ka mungesë konkurrence midis kandidatëve kur paraqitet vetëm një ofertues ose nuk paraqitet asnjë i tillë;

h) Në nenin 41, pika 1, shkronja "b" ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

b) të gjithë ofertuesit nuk kalojnë fazën e kualifikimit ose e kalon vetëm njëri prej tyre;

i) në nenin 41, pika 1, shkronja "c" ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

c) asnjë kuotim ose ofertë e sjellë nuk plotëson kërkesat dhe/ose specifikimet teknike të kërkuara nga Banka e Shqipërisë ose i plotëson vetëm njëra prej tyre;

j) në nenin 49, shkronja "a", shtohet pika e parë me këtë përmbajtje:

- ndarjen në lote të objektit të prokurimit kur çmohet e nevojshme;

k) në nenin 51, pas togfjalëshit "...institucione të tjera shtetërore përkatëse", shtohet togfjalëshi " ... kur ky informacion është i disponueshëm";

l) në nenin 51, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafe sipas përmbajtjes së mëposhtme:

- Në rastet e prokurimit të drejtpërdrejtë, studimi i tregut realizohet vetëm me ofertën e kandidatit të ftuar.

- Në rast përsëritjeje të procedurës së prokurimit, ofertat mbi studimin e tregut mund të përdoren si bazë në studimin pasardhës, kur përsëritja e procedurave, të prokurimit realizohet brenda tre muajve nga data e studimit të parë të tregut.

m) Në nenin 51, paragrafi i parafundit ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Procedurat e prokurimit, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, mbikëqyren nga juristi i angazhuar në procedurën e prokurimit, i cili konfirmon rregullsinë e procedurës në procesverbalet e mbledhjeve dhe në vendimin e Komisionit të Prokurimit.

2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit dhe strukturat e tjera të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

KËRKESË
Nr.7207, datë 13.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga grupi i punës ngritur për këtë qëllim vlerësim, i cili është miratuar më pas nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet

përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që, për pronarët për të cilët nuk është publikuar vlera e kulturave bujqësore dhe drufrutorë, dokumentacioni i vlerësimit nuk është i plotë dhe i rregullt, për këtë arsye do t'i kthehet subjektit kërkues, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve për korrigjim.

Pronari për të cilin në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Rikonfirmim", nuk është konfirmuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin. Me mbarimin e afatit trejavor nga dita e parë e publikimit (afat gjatë të cilit pronarët kanë të drejtë të paraqesin ankimet e tyre), nëse nuk do të konfirmohet më pas nga ZRPP Kurbin, do të përjashtohet nga shpronësimi, deri në momentin që do të ketë një konfirmim nga kjo zyrë lidhur me titullin e pronësisë.

Pronarët, për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 11 387 349 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA SHTESË PËR SEGMENTIN RRUGOR MILOT-RRËSHEN

Nr.	Pronari			Nr.pas.	Tokë arë			Tokë truall			Pyll, kullotë			Kultura bujq+druf.	Vlera Totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip.m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë	Sip.m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë	Sip.m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë			
	Fshati Shullaz Z.K.3441															
1	Nikoll	Dod	Ndreca	3/13	150	383	57450								57450	Konfirmuar nga ZRPP
Fshati Mal i Bardhë Z.K.25/80																
2	Elez	Isuf	Lika	97/23	38	271	10298							46000	56298	Konfirmuar nga ZRPP
3	Reme	Beqir	Smaci	91/50	185	271	50135								50135	Konfirmuar nga ZRPP
4	Shqipe	Xhemal	Lika	91/42	335	271	90785							10184	100969	Konfirmuar nga ZRPP
5	Hasan	Xhaferr	Lika	91/38	349	271	94579							33175	127754	Konfirmuar nga ZRPP
6	Gjergj	Ndue	Mëhilli	92/25	890	271	241190								241190	Konfirmuar nga ZRPP
7	Musa		Smaci	91/55	528	271	143088								143088	Konfirmuar nga ZRPP
8	Lik	Hasan	Lika	91/41	240	271	65040								65040	Konfirmuar nga ZRPP
9	Frrok	Vorf	Palaj	28/50	285	271	77235								77235	Konfirmuar nga ZRPP
10	Sandër	Ndue	Mëhilli	91/3	114	271	30894								30894	Konfirmuar nga ZRPP
Fshati Fushë-Milot Z.K.1677																
11	Islam	Beg	Shabani	29/15	186	381	70866								70866	Konfirmuar nga ZRPP
12	Xhemal	Ahmet	Lika	37/47	148	381	56388								56388	Konfirmuar nga ZRPP
13	Haki	Caf	Veseli	42/17	236	381	89916								89916	Konfirmuar nga ZRPP
14	Isuf	Caf	Veseli	42/18	255	381	97155								97155	Konfirmuar nga ZRPP
15	Qemal	Caf	Veseli	42/25	287	381	109347								109347	Konfirmuar nga ZRPP
16	Murat	Hasan	Veseli	42/26	312	381	118872							121200	240072	Konfirmuar nga ZRPP
17	Hajredin	Mus	Veseli	55/80	239	381	91059							18200	109259	Konfirmuar nga ZRPP
18	Beqir	Mus	Veseli	55/86	389	381	148209								148209	Konfirmuar nga ZRPP
19	Shaban	Ram	Kapllani	44/61	552	381	210312							11750	222062	Konfirmuar nga ZRPP
20	Mehmet	Hajdar	Veseli	44/56	633	381	241173								241173	Konfirmuar nga ZRPP
21	Pal	Pjetër	Çerri	45/62	232	381	88392								88392	Konfirmuar nga ZRPP
22	Fran	Pjetër	Çerri	45/63	140	381	53340								53340	Konfirmuar nga ZRPP
23	Pjetër	Pjetër	Çerri	45/52	190	381	72390								72390	Konfirmuar nga ZRPP
24	Gjin	Pjetër	Çerri	45/45	180	381	68580								68580	Konfirmuar nga ZRPP
25	Alban	Ndue	Çerri	45/50	140	381	53340								53340	Konfirmuar nga ZRPP
26	Martin	Gjergj	Çerri	45/48	225	381	85725								85725	Konfirmuar nga ZRPP
27	Nikoll	Gjergj	Çerri	45/47	151	381	57531								57531	Konfirmuar nga ZRPP
28	Shaban	Kasem	Sula	109/4	1325	381	504825								504825	Konfirmuar nga ZRPP
29	Islam	Sali	Sula	109/5	370	381	140970								140970	Konfirmuar nga ZRPP
30	Ali	Baft	Sula (B)	109/6							1076	251	270076		270076	Konfirmuar nga ZRPP
31	Fatmir	Must	Bajrami	110/7							2071	254	526034		526034	Konfirmuar nga ZRPP
32	Idriz	Nezir	Bajrami	110/8							2268	254	576072		576072	Konfirmuar nga ZRPP
Qyteti Milot Z.K 2693																

33	Bashkëpronësi			3/40				782	1330	1040060					1040060	Konfirmuar nga ZRPP
34	Nikoll	Pjetër	Kola	3/107				200	1330	266000					266000	Konfirmuar nga ZRPP
35	Fejzulla	Musli	Saraçi	3/111				74	1330	98420					98420	Konfirmuar nga ZRPP
36	Spartak	Fejzulla	Saraçi	3/110				200	1330	266000					266000	Konfirmuar nga ZRPP
37	Pjetër	Ndue	Preçi	3/20				24	1330	31920					31920	Konfirmuar nga ZRPP
38	Mikel	Ndoc	Kola	3/19				577	1330	767410				410400	1177810	Konfirmuar nga ZRPP
39	Marie	Ded	Kola	1/56				255	1330	339150					339150	Konfirmuar nga ZRPP
40	Zef	Ndoc	Kola	3/94				214	1330	284620					284620	Konfirmuar nga ZRPP
Fshati Skuraj Z.K.3469																
41	Beg	Ali	Ahmeti	510	1093	140	153020								153020	Konfirmuar nga ZRPP
42	Ram	Hassan	Lika	511	1060	140	148400								148400	Konfirmuar nga ZRPP
Fshati Ferr-Shkopet Z.K.3470																
43	Mark	Nikoll	Malçi	34/3	1152	182	209664								209664	Konfirmuar nga ZRPP
44	Zef	Bardhok	Bardhoku	34/3	1306	182	237692								237692	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali			13915		3967860	2326		3093580	5415		1372182	650909	9084531	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA SHTESË PËR SEGMENTIN RRUGOR MILOT-RRËSHEN

Nr.	Pronari			Nr.pas.	Tokë arë			Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë		
Fshati Fang Z.K.1601									
1	Ndue	Gjergj	Malshi	43/1,2	125	241	30125	30125	Konfirmuar nga ZRPP
2	Pal Marjana Marte	Frrok Pal Lekë	Malshi Malshi Malshi	67	225	241	54225	54225	Konfirmuar nga ZRPP
3	7 Bashkëpronarë			63/1	93	241	22413	22413	Konfirmuar nga ZRPP
4	Luigj	Preng	Marku	62/4	131	241	31571	31571	Konfirmuar nga ZRPP
5	Nikoll	Pal	Fusha	58/2	673	241	162193	162193	Konfirmuar nga ZRPP
6	Kol	Frrok	Malshi	49/1	121	241	29161	29161	Konfirmuar nga ZRPP
7	Geg	Ndue	Ndoka	49/3	169	241	40729	40729	Konfirmuar nga ZRPP
8	Geg	Frrok	Paloka	55/3	297	241	71577	71577	Konfirmuar nga ZRPP
9	Pjetër	Gjin	Vokrri	55/4	528	241	127248	127248	Konfirmuar nga ZRPP
10	Gjok	Bib	Vokrri	55/5	240	241	57840	57840	Konfirmuar nga ZRPP
11	Ndue	Nikoll	Zamaku	137/10	394	241	94954	94954	Konfirmuar nga ZRPP
12	Preng	Ndue	Lleshi	137/3	433	241	104353	104353	Konfirmuar nga ZRPP
13	Preng	Nikoll	Zamaku	137/7	434	241	104594	104594	Konfirmuar nga ZRPP
14	Marjam	Gjin	Gjini	137/1	376	241	90616	90616	Konfirmuar nga ZRPP
15	Zef	Preng	Trumshi	137/2	603	241	145323	145323	Konfirmuar nga ZRPP
16	Ndue	Preng	Lleshi	137/4	1015	241	244615	244615	Konfirmuar nga ZRPP
17	Fran	Mark	Karagjozi	137/13	578	241	139298	139298	Konfirmuar nga ZRPP
18	Fatjon	Gjon	Lesaj	137/15	187	241	45067	45067	Konfirmuar nga ZRPP
19	Frrok	Pal	Fusha	55/6	56	241	13496	13496	Konfirmuar nga ZRPP
20	Lek	Nikoll	Fusha	55/7	390	241	93990	93990	Konfirmuar nga ZRPP
21	Marjam	Gjin	Gjini	141/10	420	241	101220	101220	Konfirmuar nga ZRPP
22	Paulin	Gjin	Gjini	112/2	77	241	18557	18557	Konfirmuar nga ZRPP
23	Zef	Pal	Gjini	112/3	48	241	11568	11568	Konfirmuar nga ZRPP
24	Ilir	Zef	Kiku	148	960	241	231360	231360	Konfirmuar nga ZRPP
25	Preng	Ndue	Guri	155/11	63	241	15183	15183	Konfirmuar nga ZRPP
26	Preng	Ndue	Guri	153/6	150	241	36150	36150	Konfirmuar nga ZRPP
27	Pal	Preng	Perlesi	155/10	340	241	81940	81940	Konfirmuar nga ZRPP
Fshati Vau-Shkjez Z.K.3721									
28	Valentin	Gjin	Gega	29/2	299	233	69667	69667	Konfirmuar nga ZRPP
29	Ilir	Llesh	Gjoka	66/10	145	233	33785	33785	Konfirmuar nga ZRPP
	Totali				9570		2302818	2302818	

KËRKESË
Nr.7207/3, datë 21.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rrethrrotullimi Lezhë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 2 409 528 (dy milionë e katërqind e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT “PËRMIRËSIMI I SIGURISË RRUGORE RRETHRROTULLIMI LEZHË”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr.pasurisë	Lloji i pasurisë						Vlera totale (lekë)	Shënime
						Arë			Truall				
						Sip	Çmimi	Vlera	Sip	Çmimi	Vlera		
1	Shoq. “Autogril Vilson” sh.a			1987	180/98		428	0	306	3182	973692	973692	Konfirm nga ZVRPP
2	Ilir	Ramazan	Gjoçi	1987	180/44	115	428	49220		3182	0	49220	Konfirm nga ZVRPP
3	Fatmir	Hakik	Hoti	1987	104/28	90	428	38520		3182	0	38520	Konfirm nga ZVRPP
4	Bibe	Preng	Frroku	1987	180/36		428	0	340	3182	1081880	1081880	Konfirm nga ZVRPP
5	Mark	Gjok	Ivanaj	1987	104/27	87	428	37236		3182	0	37236	Konfirm nga ZVRPP
6	Gjok	Ded	Deda	1987	104/15	398	428	170344		3182	0	170344	Konfirm nga ZVRPP
7	Bibe	Simon	Nikolla	1987	104/3	137	428	58636		3182	0	58636	Konfirm nga ZVRPP
								353956			**2055572**	**2409528**	

KËRKESË
Nr.2764/1, datë 11.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i stacionit të pompimit Tushemisht.

Subjekti kërkues i këtij objekti është sh.a. ujësjellës-kanalizime, Pogradec. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen e titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 62 490 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë.

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË STACIONIT TË POMPIMIT, TUSHEMISHT, POGRADEC

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr.pas.	Lloji i pas.	Sip m^2	Çmimi m^2/lekë	Vlera (lekë)
1.	Hil	Ndoc	Hila	3664	4/8	Tokë/arë	100	624.9	62 490

KËRKESË
Nr.8149/1, datë 24.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rrëshen-Kalimash" (objekte).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Në këtë publikim është pasqyruar vetëm vlerësimi i objekteve, ndërsa sipërfaqja e tokës që preket do të publikohet në një moment të dytë, pasi të bëhen plotësimet përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Pronarët, për të cilët në kolonën "Shënime" në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë, i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 6 109 173 (gjashtë milionë e njëqind e nëntë mijë e

njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

	Pronari		**ZK**	**Nr.pas.**	**Objekt vlera lekë**	**Shënime**
Gjok	Ndue	Gega	1190	27/7	3125158	Konfirmuar nga ZRPP
Ndrec	Ndue	Gega	1190	27/6	2984015	Konfirmuar nga ZRPP
	Totali				**6109173**	

KËRKESË
Nr.5064/4, datë 26.11.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve z.Fiqeri Bregu, z.Rahman Neziri dhe z.Gani Nerjaku.

Subjekti kërkues është komuna Xhafzotaj. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet prej 2 000 m^2 tokë arë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personi që ka emrin, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

Fatura, sipas formatit të mësipërm, t'i dërgohet për likuidim komunës Xhafzotaj.

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË KOMUNËN XHAFZOTAJ

Nr.	**Emër, mbiemër**	**Sipërfaqja në m^2**	**Çmimi në lekë**	**Vlera**	**Lloji i dokumentit**	**Zona kadastrale**	**Nr. pasurisë**
1	Fiqeri Bregu	400	1250	500.000	Çert.pronësie	3852	110/1
2	Rahman Neziri	680	1250	850.000	Çert.pronësie	3852	110/35
3	Gani Nerjaku	729	1250	911.250	Çert.pronësie	3852	110/33
4	Gani Nerjaku	191	1250	238.750	Çert.pronësie	3852	110/31
	Shuma në total	**2 000**	**1250**	**2.500.000**			

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 11.12.2008
Doli nga shtypi më 11.12.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2008

Çmimi 60 lekë